

LEDIA DUSHKU

**NGA TË MANDATUAR NË KOHË LUFTE,
NË TË ZGJEDHUR NË PERIUDHË PAQEJE:
NJË QASJE KRAHASUESE E TIPAREVE
TË PËRFAQËSIMIT NË KUVENDIN KOMBËTAR
TË VLORËS DHE PARLAMENTIN E VITIT 1921**

Abstrakt:

Artikulli “Nga të mandatuar në kohë lufte, në të zgjedhur në periudhë paqeje: një qasje krahasuese e tipareve të përfaqësimit në Kuvendin Kombëtar të Vlorës dhe Parlamentin e vitit 1921” ka si qëllim të shpjegojë e krahasojë tiparet e përfaqësimit të shqiptarëve në dy momente kyçe, fillimisht në Kuvendin Kombëtar të Vlorës e mandej në zgjedhjet e vitit 1921. Jo rastësisht si pikënisje është marrë Kuvendi i Vlorës, sepse aty u formësua modeli me dy boshte kryesore mbi të cilat do të duhej të përvijohesh edhe në të ardhmen përfaqësimi i shqiptarëve. Zgjedhjet parlamentare të vitit 1921 janë të parat e këtij lloji në historinë e shtetit shqiptar, të mbajtura në periudhë paqeje, prej të cilave doli një parlament i tipit klasik. Artikulli ka një qasje paralele-krahasimore, sa historike aq edhe juridike, midis këtyre dy momenteve të rëndësishme në historinë e shtetformimit shqiptar, duke synuar t’i japë përgjigje pyetjeve: Cilat ishin veçoritë e përfaqësimit të shqiptarëve në Kuvendin e Vlorës? Duke qenë se veproi në kushte të jashtëzakonshme lufte, si u mandatuan delegatët e tij? Si u zbatua modeli i përfaqësimit, i krijuar në Kuvendin e Vlorës, në rastin e zgjedhjeve të vitit 1921? Cilat shtylla të këtij niveli përfaqësimi hasën vështirësi, duke mos u zbatuar ose rimodeluar?

Fjalë kyçe:

Shqipëri, Kuvendi Kombëtar i Vlorës, mandate përfaqësimi, përfaqësimi krahonor, përfaqësimi fetar, zgjedhje parlamentare, Ligji i Zgjedhjeve, diasporë, shqiptarët në Kosovë, shqiptarët në Greqi.

Tiparet e përfaqësimit në Kuvendin Kombëtar të Vlorës

Studiuesja Aurela Anastasi ndan mendimin se Kuvendi Kombëtar i Vlorës është plotësisht i ngjashëm me asambltetë kushtetuese në botë, të mbledhura në situata të jashtëzakonshme për të marrë vendime të rëndësishme, për të miratuar kushtetuta ose karta të drejtash.¹ Ndonëse nuk ishte parlamenti tipit klasik, i formuar mbi bazën e përfaqësimit konkurues me anë të zgjedhjeve, sikurse ai që veprroi në Shqipëri në vitet 1921-1924, kuvendi ruan karakterin e tij përfaqësues dhe legjitim. Ky karakter u afirmua dukshëm edhe nga mbështetja masive që ai mori nga shqiptarë brenda dhe jashtë vendit, me anë të telegrameve që arrinin vazhdimisht në Vlorë.² Shqipëria siguroi kështu një mazhorancë të brendshme të qëndrueshme, që e mbështeste në atë çast hapin shkëputës nga Perandoria Osmane dhe krijimin e shtetit të pavarur.

Në një situatë të jashtëzakonshme lufte e pushtimi, sikurse ndodheshin shqiptarët në vjeshtën e dytë të vitit 1912, dy janë tiparet dalluese të përfaqësimit në Kuvendin Kombëtar të Vlorës:

Së pari, organizatorët u kujdesën të siguronin përfaqësimin e sa më shumë krahinave dhe qyteteve shqiptare, mundësisht të të gjithë kombit. U përfaqësuan Berati, Çamëria, Delvina, Dibra, Durrësi, Elbasani, Gramshi dhe Tomorrica, Gjirokastra, Gjakova, Peja, Plava, Gucia, Kavaja, Korça, Kosova, Kruja, Lushnja, Mati, Ohri, Struga, Peqini, Përmeti, Starova (Pogradeci), Shijaku, Shkodra, Tepelena, Tirana, Vlora.³ Panorama u plotësua edhe me përfaqësimin e diasporës shqiptare, nëpërmjet të dërguarve të Bukureshtit, të cilët dolën nga mbledhja e 5 nëntorit 1912, mbajtur në hotel “Continental”, në kryeqendrën e Rumanisë.

¹ Aurela Anastasi, *Historia e të drejtës kushtetuese në Shqipëri (1912-1939)*, Tiranë: Pegi, 2007, f. 16.

² *Po aty*, f. 21- 22.

³ *Ligjvënësit shqiptarë (1912-2017) dhe firmëtarët e aktit të Pavarësisë*, ribotim i përditësuar, Kuvendi i Shqipërisë, Tiranë: 2018, f. 15-16; Lef Nosi, *Dokumenta historike për t'i shërbye historiës tonë kombëtare, 1912-1918*, botim i dytë, me rastin e 95-vjetorit të Shpalljes së Pavarësisë së Shqipërisë, përgatiti për botim Ferit Duka, Marenglen Verli, Tiranë: Nënë Tereza, 2007; Kastriot Dervishi, *Historia e shtetit shqiptar 1912-2005*, Tiranë: Shtëpia botuese “55”, 2006, f. 20; Aleksandër Meksi, “Kuvendi i Vlorës, pjesëmarësit dhe firmëtarët e aktit të Pavarësisë”, *Hylli i Dritës*, nr. 3, Shkodër, 2012.

Sa i përket mënyrës së dhënies së mandatit, pjesa më e madhe e delegatëve e morën atë drejtpërsëdrejti nga përfaqësitë lokale që shprehnin vullnetin e gjithë popullsisë së zonës apo qytetit që ata përfaqësonin. Këto të fundit kishin përgjithësisht në përbërje të tyre emra të zëshëm të parive lokale, kryetarin e bashkisë, përfaqësues të komuniteteve fetare etj. Të tilla mandate morën delegatët e Elbasanit, Durrësit, Beratit, Vlorës, Ipekut, Kavajës, Krujës, Lushnjës, Ohrit, Strugës, Matit. Por, kishte edhe nga ata që për një arsye apo tjetër ndodheshin në Vlorë dhe mandati i përfaqësimit iu dha nga Kuvendi i Vlorës, apo ai u delegua aty, me telegram nga përfaqësitë lokale. Një rast, ndër disa të tillë, ishte mandati i përfaqësimit dërguar nga Tepelena për Aristidh Rucin, nga fshati Sheper, që në atë moment ishte tregtar në Vlorë. Pati edhe ndonjë rast, si ai i Sherif Rulit, i cili për shkak të ndodhjes në qytetin bregdetar, ia kërkoi vetë mandatin e përfaqësimit Libohovës, por pa mundur ta sigurojë atë.⁴ Kjo mënyrë e delegimit të mandateve, bëri edhe një shpërndarje të detyruar të nivelit të përfaqësimit, në zona apo qytete të cilat në kushtet e Luftës së Parë Ballkanike e kishin të pamundur të dërgonin përfaqësues, pavarësisht dëshirës dhe vullnetit. Në këtë mënyrë u siguroa një përfaqësim kombëtar thuajse i pacunguar, por që në përgjithësi nuk reflektonte numrin e popullsisë që vetë zona apo qyteti kishte. Kështu Shkodra e rrethuar nga ushtria malazeze, pavarësisht popullsisë së madhe në numër u përfaqësua vetëm nga një delegat. Ai ishte Luigj Gurakuqi, ardhur nga Triestja së bashku me Ismail Qemalin dhe përfaqësuesit e kolonisë së Bukureshtit. Mandatin e përfaqësimit atij ia dha Kuvendi i Vlorës, pas propozimit të Mustafa Krujës.⁵ Nga ana tjetër, Korça “*e qarkuar nga ushtria greke*”, në pamundësi për të dërguar delegatë, u përfaqësua nga Pandeli Cale, Spirodon Ilo, Thanas Floqi, të ardhur nga Bukureshti, të cilët e morën mandatin e përfaqësimit po nga Kuvendi, pas propozimit të Sali Gjukës.⁶ Për të njëjtën arsye, Kuvendi i dha mandate përfaqësimi edhe të dërguarve të Çamërisë: Azis Tahir Ajdonatit, Rexhep Demi Ajdonatit,

⁴ L. Nosi, *Dokumenta historike për t'i shërbye historiës tonë kombëtare....*, f. 95, Telegram i Sherif Rulit për kryesinë e bashkisë në Libohovë, Vlorë, 15/28 nëntor 1912.

⁵ *Po aty*, f. 177. Mbledhja e parë e Kuvendit të Vlorës, 28 nëntor 1912.

⁶ *Po aty*.

Veli Gërra Ajdonatit, Vesel Margëlliçi Ajdonati, pas propozimit të Myfit Libohovës.⁷

Interesant mbetet niveli i përfaqësimit të Kosovës, me numër të njëjtë delegatësh sikurse krahina e Çamërisë. Dervish Ipeku, Hajdin Draga, Isa Boletini dhe Mehmet Dëralla, ishin katër të mandatuarit, të cilët morën pjesë në mbledhjen e datës 30 nëntor të Kuvendit Kombëtar të Vlorës, një ditë pas mbërritjes së tyre.⁸ Në dallim nga krahina e Çamërisë, mandatin e tyre nuk e bëri Kuvendi Kombëtar. Ndonëse në dokumentacionin e deritanishëm nuk specifikohet qartësisht fakti se nga e kishin marrë ata mandatin, nisur nga përvoja e krijuar dhe e zbatuar me rigorozitet për verifikimin e mandateve, mundësia që ata ta mbartnin përfaqësimin drejtpërsëdrejti nga zona prej nga vinin, mbetet e lartë. Edhe Tajar Zavalani e Abaz Ermenji, në studimet e tyre evidentojnë faktin se delegatët e Kosovës ishin me mandat të rregullt, të zgjedhur nga qytetarët e tyre.⁹

Në një analizë më të gjerë, vihet re shumësi mandati, rrjedhojë kjo e ngutjes, mungesës së koordinimit apo të komunikimit mes zonave, në kushtet e gjendjes së jashtëzakonshme. *“Lutemi për shpëtim t’atdheut, qi përfaqësusit në fjalë, tyke e bâmë natën ditë, të gjinden në Mbledhjet të Përgjithshme Kombëtare qi do të bâhet këtu në Vlonë”*- ishte teksti shoqërues i telegramit që u përcoll nga Vlora në drejtim të qyteteve shqiptare, mesditën e datës 18 nëntor 1912.¹⁰ Në një situatë të tillë, zona të ndryshme zgjodhën të njëjtët njerëz për t’i përfaqësuar, çka ndikoi që në kuvend të kishte 5 delegatë që mbartnin 11 mandate përfaqësimi: Mit’hat Frashëri, përfaqësoi Elbasanin, Ipekun, Përmetin; Myfit Libohova, Gjirokastrën dhe Tepelenën; Aristidh Ruci ishte delegat i

⁷ *Po aty*, f. 182. Mbledhja e katërt e Kuvendit të Vlorës, 3 dhjetor 1912.

⁸ *Po aty*, f. 179. Mbledhja e dytë e Kuvendit të Vlorës, 30 nëntor 1912.

⁹ Afrim Krasniqi, *Partitë politike në Shqipëri (1920-2006). Historia dhe tiparet e partive, parlamenteve dhe të zhvillimeve politike në Shqipëri*, Instituti Shqiptar i Studimit të Politikave, Tiranë: 2006, f. 35.

¹⁰ L. Nosi, *Dokumenta historike për t’i shërbye historiës tonë kombëtare.....*, f. 69-70. Telegram i Xhemil Vlorës, Elmas Kaninës dhe Leonidha Bezhanit për kryetarët e bashkive, parisë dhe popullsisë së Janinës, Gjirokastrës, Reshadies, Tepelenës, Delvinës, Përmetit, Margëlliçit, Leskovikut, Kolonjës, Korçës, Dibërës, Manastirit, Resnjes, Kosturit, Strugës, Ohrit, Beratit, Pogonit, Skraparit, Lushnjës, Elbasanit, Kavajës, Durrësit, Tiranës, Krujës, Matit, Shkodrës, Peqinit dhe Fierit, Vlorë, 5 nëntor 1328 (18 nëntor 1912).

Vlorës dhe Tepelenës; Abdi Toptani i Krujës dhe Tiranës, ndërsa Veli Këlcyra i Përmetit dhe Gjirokastrës.

Por panorama e përfaqësimit nuk përjashtoi edhe disa delegatë, të cilët nuk e ushtruan mandatin e dhënë, për shkak se nuk mundën të mbërrinin në Vlorë. Të tillë ishin babë e bir, Syrja e Eqrem Vlora, si edhe Dhimitër Ilo. Ndërkohë Hajdar Blloshmi, i zgjedhur nga Starova (Pogradeci) dhe Dervish Hima, përfaqësues i Ohrit dhe Strugës, ndonëse mbërritën në Vlorë më 6 dhjetor 1912, nuk morën pjesë në punimet e ditës së fundit, për arsye që dokumentacioni i derisotëm nuk i specifikon.¹¹

Aspekti i dytë i karakterit përfaqësues të Kuvendit të Vlorës është përfaqësia në raport me përkatësinë fetare të popullsisë. “*Nga çdo anë po zgjidhen e po çohen përfaqësues. Edhe ju aty urdhënoni e zgjidhni dy përfaqësues, njanin mysliman e tjetrin të krishtenë edhe i dërgoni në Vlonë*” - i shkruante në nëntor 1912, Aqif Pashë Biçakçiu nga Elbasani, kryesisë së bashkisë së Starovës.¹² Respektimi i këtij raporti merrte një rëndësi të veçantë në kushtet kur shqiptarët ishin heterogjenë nga pikëpamja fetare. Ai shmangte rrezikun e shndërrimit të Shqipërisë në një shtet mysliman, vendoste një marrëdhënie harmonike mes grupeve të besimeve të ndryshme, ruante me kujdes një bashkëjetesë të qetë, pa shumë tensione e konflikte, duke siguruar bashkimin dhe kapërcimin e krizave shpërbërëse për shtetin. Në sajë të këtij kujdesi, Kuvendi Kombëtar i Vlorës u konfigurua duke ruajtur përgjithësisht raportet mes tre besimeve fetare që vepronin në Shqipëri. Kështu, nga 83 mandate përfaqësimi, 17 prej tyre (22%) i përkisnin të krishterëve (15 ortodoksë dhe 2 katolikë). Argjipeshkopata e Durrësit, në emër të të gjithë shqiptarëve katolikë që ndodheshin nën urdhrin e saj, u përfaqësua nga dom Nikoll Kaçorri. Elementi ortodoks ishte krah atij mysliman, ku spikatnin veçanërisht delegatët e kolonisë së Bukureshtit.

Dy tiparet e përfaqësimit u ruajtën në tërësinë e tyre edhe në formimin e institucioneve vetëqeverisëse: qeverisë dhe pleqësisë, ndonëse kjo nuk rezultoi një punë e lehtë. Interesant mbetet diskutimi i zhvilluar në mbledhjen e datës 3 dhjetor 1912, ku kryetari i qeverisë paraqiti kriteret që duhej të përmbushnin për zgjedhjen e ministrave.

¹¹ *Po aty*, f. 185. Mbledhja e shtatë e Kuvendit të Vlorës, 7 dhjetor 1912.

¹² *Po aty*, f. 70-71. Telegram i Aqif Pashë Biçakçiu për kryesinë e bashkisë së Starovës, nëntor 1912.

Kabineti duhej të “*kënaqë Evropën me një anë dhe Stambollën në anën tjetër...*, duhet të jenë emra të njohura në Shqipëri dhe jashtë Shqipërisë”. Por, çuditërisht lista e paraqitur, ndonëse kishte në përbërje të saj personalitete me kontribut në çështjen kombëtare, nuk reflektonte një shpërndarje gjithëpërfshirëse krahinore dhe fetare, ashtu sikurse pritej.¹³ Në të tillë situatë, disa prej delegatëve reagues. I pari ishte Babë Dud Karbunara, i cili kundërshtoi faktin se në listë nuk gjendej asnjë i krishterë, qëndrim i cili u mbështet edhe nga Pandeli Cale, Dhimitër Berati dhe Qemal Karaosmani. Votimi nuk u krye dhe u shty për ditën vijuese. Ismail Qemal Vlora u tërhoq dhe, më 4 dhjetor 1912, mbi bazën e një marrëveshjeje mirëkuptimi, mbështetur mbi kritere më të balancuara krahinore e fetare, Kuvendi zgjodhi Qeverinë e Përkohshme. Ajo kishte në përbërjen e saj 9 anëtarë së bashku me kryeministrin, prej të cilëve 5 ishin të besimit mysliman, 4 të atij të krishterë (3 ortodoksë dhe 1 katolik).¹⁴ Kjo shpërndarje nuk reflektonte drejtë raportin e besimeve fetare në Shqipëri, duke favorizuar atë të krishterë. Ndonëse nuk e gjen të shprehur qartësisht në dokumentacion, priremi të arsyetojmë se një gjë e tillë bëhej për të shmangur etiketimin e Shqipërisë si një shtet mysliman, duke synuar një qasje evropiane të tij.

Pleqësia, në dallim nga qeveria, ruajti të njëjtin raport përfaqësimi sa i përket aspektit fetar, sikurse vetë Kuvendi Kombëtar i Vlorës. Nga 18 anëtarë të saj, 4 ishin të krishterë (22%) dhe 14 myslimanë (78%). Përgjithësisht ajo kishte një shpërndarje të ekuilibruar krahinore.¹⁵

Kuvendi i Vlorës, me tiparet e nivelit të përfaqësimit të vendosura, krijoi modelin me të cilin do të duhej të veprohej, sa herë do të kishte zgjedhje përfaqësuesish, qofshin këto për kongrese kombëtare apo parlamente. Ky model u formësua me dy kapilarë bazikë: përfaqësim sa më të plotë kombëtar, pa përjashtuar diasporën, si dhe respektim në

¹³ Emrat e propozuar ishin Mehmet Pashë Tetova, Myfit Bej Gjirokastra, Azis Pashë Gjirokastra, Vehbi Efendi Dibra, Abdi Bej Toptani dhe Mit'hat Bej Frashëri. Shih: L. Nosi, *Dokumenta historike për t'i shërbye historiës tonë kombëtare...*, f. 182. Mbledhja e datës 3 dhjetor 1912.

¹⁴ *Po aty*, f. 183. Mbledhja e datës 4 dhjetor 1912. Qeveria përbëhej nga Luigj Gurakuqi – ministër i Arsimit (Edukimit), Myfit Libohova – ministër i Punëve të Brendshme, Mehmet Pashë Deralla – ministër i Luftës, Abdi Toptani – ministër i Financave, Mit'hat Frashëri – ministër i Punëve Botore, Petro Poga – ministër i Drejtësisë, Pandeli Cale – ministër i Bujqësisë dhe Lef Nosi – ministër i Postë-Telegrafeve. Ismail Qemali mbajti përkohësisht edhe postin e ministrit të Punëve të Jashtme.

¹⁵ *Po aty*.

nivelin e përfaqësimit të raporteve të besimeve fetare të popullsisë. Edhe pse Kuvendi Kombëtar i Vlorës, Qeveria e Përkohshme dhe Pleqësia nuk u formatuan mbështetur në sistemin e zgjedhjes, të funksionimit institucional dhe të debatit konkurrues politik, shkëndija që ata dhanë, ndihmoi në zhvillimet e shpejta politike dhe parlamentare të fillim viteve '20.¹⁶

Pranverë 1921: Zgjedhjet parlamentare dhe përfaqësimi politik në Këshillin Kombëtar

Kur bëhet fjalë për zgjedhjet parlamentare të pranverës së vitit 1921 duhet të kemi parasysh faktin se ato zhvilloheshin në një situatë të paqte dhe joanormale e të jashtëzakonshme sikurse ishin mandatuar delegatët e Kuvendit Kombëtar të Vlorës e më tej, ata të Kongresit të Durrësit (1918)¹⁷ dhe të Lushnjës (1920).¹⁸ Lufta e Parë Botërore kishte

¹⁶ A. Krasniqi, *Partitë politike në Shqipëri ...*, f. 38.

¹⁷ Në Kongresin e Durrësit, mbajtur më 25 dhjetor 1918, kur sapo kishte përfunduar Lufta e Parë Botërore, nuk pati përfaqësim të plotë kombëtar. U mandatuan 53 delegatë, nga zona të ndryshme të Shqipërisë Londineze, përjashtuar Korçën dhe Vlorën, të pushtuar nga francezët dhe italianët. Nuk pati asnjë përfaqësues nga popullsia shqiptare jashtë shtetit amë. Ndërkohë në përfaqësim përgjithësisht u respektua raporti i besimeve fetare të popullsisë. Nga 53 delegatë gjithsej, 16 prej tyre (30%) i përkisnin të krishterëve (14 ortodoksë dhe 2 katolikë). Shih: Teki Selenica, *Shqipëria më 1927. L'Albanie en 1927*, Tiranë: Shtypshkronja "Tirana", 1928, Pasqyra (A) e faqes XXI.

¹⁸ Kuvendi i Lushnjës u hap më 21 janar 1920, por punimet i zhvilloi pak ditë më vonë, nga 28-31 janar 1920. Ashtu sikurse Kuvendi i Vlorës dhe Kongresi i Durrësit, delegatët edhe në këtë rast nuk u zgjodhën përmes organizimit të zgjedhjeve, por u mandatuan si të tillë prej përfaqësive lokale. Ndonëse, përfaqësimi kombëtar ishte më i plotë se ai i Kongresit të Durrësit, ishte e pamundur që ai të arrinte në nivelin e Kongresit të Vlorës. Në Kongresin e Lushnjës u siguruan mandate përfaqësimi për të gjithë territorin e Shqipërisë Londineze, përfshirë edhe Kosovën, duke lënë jashtë diasporën dhe krahinën e Çamërisë. Pavarësisht mandateve të siguruara, për shkak të vështirësive të krijuara nga italianët, nga propaganda e disa krerëve të qeverisë së Durrësit dhe nga elementë të ndryshëm filoitalianë, nuk mundën të merrnin pjesë fizikisht në kongres delegatët e Shkodrës, Lezhës e të rrethinave të Malësisë së Gjakovës. Prefektura që kishte numrin më të madh të delegatëve ishte ajo e Gjirokastrës, me 10 syresh. Në një analizë të përgjithshme, përfaqësimi në kongres i Gjirokastrës kishte vlerë të dyfishtë, si një qytet që ishte ende i pushtuar nga italianët dhe si një kundërpeshë ndaj Myfit Libohovës, personalitet me peshë në zonë, e njëkohësisht kritik i madh i këtij kongresi që vepronte në hullinë e politikës italiane, por edhe si një goditje e politikës aneksioniste greke. Sa i përket raporteve të

përfunduar, ushtritë e huaja ishin larguar nga vendi dhe jeta politike dalëngadalë kishte filluar të fitonte dimensionet e humbura në vitet e para të pavarësimit. Procesi i krijimit dhe stabilizimit të shtetit kombëtar kishte nisur të merrte udhë. Institucionet e dala nga Kongresi i Lushnjës: Këshilli Kombëtar (Senati), Qeveria dhe Këshilli i Naltë, ndonëse nuk ishin konstituuar me zgjedhje por mbi bazën e kompromisit politik, kishin filluar të vepronin. Problematike mbeteshin kultura e pazhvilluar politike, ndërsa grupimet politike apo personalitetet me influencë udhëhiqeshin më së shumti nga interesat e ambicjet parciais e vetjake dhe, në përgjithësi nuk ishin në gjendje të dilnin tërësisht jashtë kufizimeve krahinore.¹⁹

Me kalimin e muajve, dalëngadalë po krijoheshin hapësira dhe mekanizma për zhvillimin e zgjedhjeve të para shumëpartiake në historinë e Shqipërisë, ndonëse pjesës më të madhe të popullsisë i mungonte kapaciteti dhe interesi për përfshirjen në procesin politik. Shteti shqiptar kishte nevojë imediate të forconte institucionet e tij dhe të përtërihej si organizëm shtetëror. Përvoja njëvjeçare e jetës parlamentare, stabiliteti politik tejet i brishtë, ndikonin në këtë drejtim. Në dhjetor të vitit 1920, pavarësisht divergjencave mes rrethëve të politikës, shumica e tyre vlerësoi si më të dobishme ripërtëritjen e parlamentit me anë të zgjedhjeve, veprim ky që mendohej se do t'i kontribuonte më mirë stabilitetit dhe forcimit të pozitave tejet të brishta ndërkombëtare të

përfaqësimit fetar, në tërësi nga 50 delegatë, 10 prej tyre (20%) ishin të krishterë (8 ortodoksë dhe 2 katolikë). Ky ishte niveli më i ulët i përfaqësimit të të krishterëve, krahasuar me Kuvendin e Vlorës dhe Kongresin e Durrësit. Ky raport u përmirësua dhe u soll më afër realit në zgjedhjen e anëtarëve të Këshillit Kombëtar (Senati). Ky i fundit u krijua nga delegatët e Kongresit të Lushnjës si organ legjislativ, me 37 anëtarë të zgjedhur, prej të cilëve 11 (29,7%) ishin të krishterë (8 ortodoksë dhe 3 katolikë). Shih: T. Selenica, *Shqipëria më 1927...*, Pasqyra (A) e faqes XXI; K. Dervishi, *Historia e shtetit shqiptar 1912-2005...*, f. 102, 114; *Ligjvënësit shqiptarë (1912-2017)...*, f. 59; Albana Mema, *Institucionet politike në Shqipëri, 1920-1924*, Tiranë: Botimet Albanologjike, 2021 (në proces botimi).

¹⁹ *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX*, vëll. II (1920-1924), Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2019, f. 43; Beqir Meta, "Procesi i ndërtimit kombëtar në vitet 1920-1930", në *100 vjet Pavarësi – Aktet e Konferencës Shkencore Ndërkombëtare Tiranë, më 26-27 nëntor 2012*, vëll. II, botim i Institutit të Historisë të Qendrës së Studimeve Albanologjike, përgatiti për botim akademik Beqir Meta, Tiranë: Kristalina-KH, 2014, f. 11-12.

shtetit shqiptar.²⁰ Shqipëria kishte një status ende të pakonsoliduar, ajo nuk ishte njohur nga asnjëra prej Fuqive të Mëdha, ndonëse më 17 dhjetor 1920 ishte pranuar në Lidhjen e Kombeve. Çështja e kufijve vijonte të ishte e papërfunduar, ndërkohë që situata me fqinjët tokësor mbetej e tensionuar. Jugosllavia mbante të pushtuar një pjesë të territorit shqiptar në prefekturën e Drinit, ndërsa Greqia 26 fshatra në juglindje, në zonën e Korçës.

Ligji për zgjedhjet, u miratua nga qeveria e Iljaz Vrionit më 5 dhjetor 1920 dhe u dekretua pak ditë më pas, më 14 dhjetor nga Këshilli i Naltë. Ky ligj i rëndësishëm për kushtetutshmërinë e institucioneve kombëtare, nuk arriti të diskutohej në parlament, pasi Këshilli Kombëtar, në këtë kohë, ishte vetëshpërndarë.²¹ Për herë të parë forcat politike patën mundësi të zhvillonin fushatë elektorale, me rivalë politikë, megjithëse me mungesë strukturash dhe programesh të qarta politike.

Sipas ligjit, zgjedhjet do të bëheshin me ndërmjetësim/votim të tërthortë dyshkallësh (*Suffrage indirect*), ku “Ç’do nënprefekturë edhe qendrat e nënprefekturavet do të pjesëtojnë [ndajnë] në qendra gjindjen (njerëzinë) simbas lehtësis së tyre nga 500 e nga 1000, edhe do të dalin në 500 një e në 1000 dy zgjedhës të dytë”.²² Të drejtë vote kishin vetëm meshkujt në moshën 20 vjeç e lart. Zgjedhësit e dytë duhej të kishin mbushur 25 vjeç dhe deputetët 30 vjeç. Ishte kusht që ata duhej të dinin gjuhën shqipe të shkruar dhe të folur. Sa i përket aspekteve të përfaqësimit neni 3 i ligjit përcaktonte vetëm se, “Për ç’do dymbillet [dymbëdhjetë]-mij shpirtë [frymë] mashkuj e femna do të dali një deputet”. Në rastet kur “mbetet tepriçë, e cila kalon dy të tretat, atëherë kjo Prefekturë fiton një Deputet domethanë 128.001 njimdhjet Deputet” (neni 19).²³ Ligji reflektonte mangësi sa i përket përfaqësimit të shqiptarëve që jetonin jashtë

²⁰ Për më shumë në lidhje me situatën politike gjatë vitit 1920 dhe rrymat e hasura në rrethet e politikës shqiptare në lidhje me zhvillimin e zgjedhjeve shih: Sali Kadria, *Nacionalizmi shqiptar në vitet 1912-1924*, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2020, f. 388-393.

²¹ Albana Mema, “Zgjedhjet politike të vitit 1921 në Shqipëri”, *Studime historike*, nr. 3-4/2020, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: 2021, f. 122.

²² *Akte të Parlamentit Shqiptar 1920-1924*, përgatitën për botim Beqir Meta, Albana Mema, Marenglen Verli, Kosta Barjaba, Akademia e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Drejtoria e Përgjithshme e Arkivave, Tiranë: 2019, f. 190-195. Ligjë për zgjedhje të deputetëve, Tiranë, 5 dhjetor 1920.

²³ Po aty.

shtetit amë, si në Jugosllavi e Greqi ashtu edhe në diasporë. Ndërkohë ai anashkalonte të drejtën e barazisë së feve, duke mos përcaktuar mekanizmat për respektimin e raporteve të besimeve fetare të popullsisë në Shqipëri.

Studiuesi Beqir Meta është i mendimit se qeveria shqiptare ishte e ndërgjegjshme se, në shoqërinë shqiptare kishte ende ndjeshmëri sa i përket përfaqësimit në institucione sipas përkatësisë fetare, mbi të gjitha duke marrë parasysh se, këtë fakt përpiqeshin ta shfrytëzonin shtetet fqinje, për të thelluar më tej përçarjet dhe për të destabilizuar shtetin shqiptar.²⁴ Në këto kushte, qeveria vendosi të ndërhyjë duke bërë një shtesë në Ligjin e Zgjedhjeve, në favor të ruajtjes së raporteve fetare të përfaqësimit të popullsisë në parlament, madje duke i rregulluar ato në favor të grupeve fetare, më të vogla në numër. Kjo ishte një zgjidhje e zgjuar dhe me efekte praktike pozitive, në konsolidimin e shtetit, veçanërisht në këtë fazë të parë e të vështirë të ndërtimit të tij, kur nevojitej unitet dhe stabilitet i brendshëm.

Për të plotësuar mangësitë, në harkun kohor 18 dhjetor 1920 - 8 janar 1921, u ndërmorën tre iniciativa ligjore. Fillimisht Ligjit të Zgjedhjeve iu bë një shtesë e menjëhershme prej 3 nenesh, njëri prej të cilëve kishte të bënte me të drejtën e barazisë në nivel përfaqësimi të feve. Neni 18 përcaktonte se *“tue marrë para sysh fenat [fetë] qi ndollin në Shqypni, do të ruhet e drejta e pa hires [barazisë] në zgjedhjen e deputetve”*.²⁵ Në një prefakturë me popullsi prej 36.000 myslimanësh dhe 24.000 të krishterësh ortodoksë dhe katolikë dilnin 5 deputetë, nga të cilët 3 myslimanë dhe 2 të krishterë. Mbas numrave të plotë prej 36. 000 myslimanë dhe 24. 000 ortodoksë e katolikë; i pari deri më 40.000 dhe i

²⁴ Shumica e deputetëve në Parlamentin Shqiptar ishin të vendosur që të bëhej gjithçka që të ruhej uniteti kombëtar. Prej tyre u përkrah propozimi i Ali Këlcyrës, i cili, ndonëse e pranonte se shqiptarët kishin ndërgjegje kombëtare, shprehte shqetësimin se mund të ndodhnin ngatërresa e përçarje. Ai sugjeroi që me vendim të Parlamentit, të respektohej përbërja fetare duke favorizuar besimet ortodokse e katolike. Në ato rajone ku ortodoksët ishin në shumicë, të zgjidhej detyrimisht një deputet ortodoks. Ndërsa në zonat ku myslimanët ishin shumicë mund të caktohej edhe një deputet nga “pakica” ortodokse. Këlcyra e përligjite propozimin e tij me faktin se shteti shqiptar nuk kishte arritur ende në shkallën e duhur të qytetërimit politik. Zgjedhjet do të duhej të bëheshin “në bazë të proporcionit të elementëve fetarë, për të vetmen arsye që shumica të mos mund të shkelte të drejtat e pakicës”. Shih: Beqir Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi kombëtar në Shqipëri 1912-1924*, Qendra e Studimeve Albanologjike, Instituti i Historisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2013, f. 327.

²⁵ *Akte të Parlamentit Shqiptar 1920-1924...*, f. 195. Shtesë e ligjit të zgjedhjeve, miratuar nga Këshilli i Naltë, Tiranë, 18 dhjetor 1921.

dyti deri më 28.000 nuk përfitonin një deputet më tepër. Kjo ndodhte vetëm atëherë kur secila prej dy grupimeve kishte një banor më tepër pra, 4.001 për myslimanët dhe 2.801 banorë për të krishterët.

Shtesat ligjore zgjidhën çështjen e përfaqësimit të pakicave fetare, duke favorizuar elementin e krishterë, kryesisht atë ortodoks, me “*qëllim që t’u mbyllet rruga propagandave të huaja dhe për të treguar se shteti shqiptar mbështetej në nacionalizëm e liberalizëm*”.²⁶ Por, pavarësisht ndërhyrjeve ligjore, më 21 shkurt 1921 në “Gazet’e Korçës” u publikua “Memorandumi i të Krishterëve Shqiptarë”, i cili e vinte theksin tek vazhdimësia e “qeverisjes orientale osmane” në shtetin shqiptar, veprim ky që sipas tij, kishte shkaktuar “shumë herë rreziqe të jetës politike e kombëtare të shtetit tonë”. Memoranduesit mendonin se vazhdimësia e praktikave të tilla sillte “vdekjen e kombit” dhe si një masë “për të shpëtuar nga këto rreziqe të sigurta” shprehnin qëndrimin e tyre për të bojkotuar zgjedhjet e përgjithshme parlamentare.²⁷ Njëkohësisht në memorandum qeverisja e centralizuar paraqitej si një e keqe e madhe “që kishte sjellë edhe në shtetet më homogjene shkatërrimin e tyre”, ndërsa decentralizimi paraqitej si faktor i përparimit dhe i qytetërimit, i aplikuar në të gjitha shtetet e përparuara dhe “si i vetmi mjet që do të siguronte bashkimin kombëtar të vërtetë dhe jo sipërfaqësor”. Për sa më sipër programi i paraqitur synonte një administratë të veçantë në Shqipërinë e Jugut, e administruar prej një guvernatori të Përgjithshëm dhe një këshilli departamentar.²⁸ Për gazetën e Vlorës “Mbrojtja Kombëtare” memorandum konsiderohej i rrezikshëm për momentin kur ishte publikuar, për faktin se vendi ishte në një periudhë prove për mundësinë e vetëqeverisjes dhe funksionimit normal të shtetit shqiptar.²⁹ Për ministrin britanik në Tiranë, Harry Eyres, refuzimi për të votuar i një pjese të madhe të popullsisë së Korçës, konsiderohej incidenti më i rëndësishëm i zgjedhjeve. Përgjegjësinë ai e kërkonte tek propaganda

²⁶ Burhan Çiraku, “Zgjedhjet e para parlamentare në Shqipëri”, në *Mbi Lëvizjen Kombëtare dhe Demokratike Shqiptare në vitet 1918-1924* (Kushtuar 40-vjetorit të Revolucionit të Qershorit 1924), botim i Universitetit Shtetëror të Tiranës, Institutit të Historisë dhe Gjuhësisë, Tiranë: 1966, f. 135 (Autori citon shkresën që Ministria e Punëve të Brendshme i dërgon prefekturës së Korçës dhe Gjirokastrës, më 21 janar 1921); S. Kadria, *Nacionalizmi shqiptar...*, f. 394.

²⁷ “Memorandumi i të Krishterëve Shqiptarë”, *Gazet’e Korçës*, nr. 70, Korçë, 19 shkurt 1921, f. 1; B. Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi kombëtar në Shqipëri ...*, f. 333-337.

²⁸ *Po aty*.

²⁹ “Me gjak të ftohtë!”, *Mbrojtja Kombëtare*, Vlorë, 4 mars 1921, f. 1.

greke “ ... e cila trumbetonte se pjesëmarrja në zgjedhje do të thoshte njohje e qeverisë shqiptare, e cila do të dobësonte pretendimet greke në Epir; dhe përpjekjet e një Partie autonome [nënkupto: grupin e nënshkruesve të memorandumit]”.³⁰

Ndërkohë që fushata elektorale ishte nderur, “Gazet’e Korçës” vijoi linjën e memorandumit dhe kritikën e ashpra e tendencioze ndaj “politikave orientale” të qeverisë së Tiranës.³¹ Si rrjedhojë vetëm pak ortodoksë morën pjesë në zgjedhje, ndërkohë që në Himarë ato u bojkotuan plotësisht. Pavarësisht pjesëmarrjes së ulët, ligji u zbatua me përpikëri e vendosmëri dhe elementi i krishterë ortodoks u favorizua. Kështu, në prefekturën e Korçës në përfundim të procesit u zgjodhën 5 deputetë myslimanë dhe 5 ortodoksë, edhe pse sipas statistikave ushtarake franceze, popullsia atje nuk ishte e ndarë përgjysmë, por numëronte 82.000 myslimanë dhe 40.000 shqiptarë ortodoksë.³² I ngjashëm ishte rezultati edhe në prefekturën e Beratit, ku sipas regjistrimit austro-hungarez të vitit 1917 kishte 27.000 ortodoksë dhe numri i deputetëve ortodoksë të zgjedhur atje ishte 3. Në prefekturën e Vlorës, ku numri i ortodoksëve ishte i papërfillshëm, u zgjodh 1 deputet, ndërsa në atë të Elbasanit 2 deputetë ortodoksë, edhe pse numri i ortodoksëve aty ishte vetëm 7.000 syresh. Në provincën e Drinit, në Shqipërinë Veriore, megjithëse nuk kishte elementë ortodoksë u zgjodhën 2 deputetë ortodoksë.³³

Por, pavarësisht respektimit të ligjit për numrin e deputetëve ortodoksë, Komisioni Hetimor i Lidhjes së Kombeve, një vit më pas do të shprehte opinionin se bojkoti e dëmtoi seriozisht përfaqësimin e popullsisë së krishterë ortodokse, pasi të zgjedhurit mund të mos përfaqësonin vullnetin real të popullsisë së Korçës. Për anëtarët e tij, frika e ndërhyrjes së qeverisë shqiptare në zgjedhje, me të cilën motivohej bojkotimi i tyre, ishte e pabazuar dhe e nxitur më shumë nga përtej kufirit. Komisioni vlerësonte se bojkotimi mbetej një mënyrë proteste, jo praktike, i cili për zgjedhjet e ardhshme do të kapërcehej dhe popullsia

³⁰ A. Mema, “Zgjedhjet politike të vitit 1921 ...”, f. 141.

³¹ “Ku është njëjësia e vërtetë?”, *Gazet’e Korçës*, nr. 74, Korçë, 5 mars 1921, f. 1; “Pushojmë kritikën...”, *Gazet’e Korçës*, nr. 77, Korçë, 16 mars 1921, f. 1; B. Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi kombëtar në Shqipëri ...*, f. 335-336.

³² B. Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi kombëtar në Shqipëri...*, f. 387.

³³ *Po aty*.

ortodokse shqiptare në jug të vendit do të merrte pjesë aktive në procesin politik.³⁴

Sa i përket përfaqësimit të katolikëve në zgjedhjet e vitit 1921, situata rezultoi edhe më e vështirë. Pati mosmarrëveshje mes Tiranës zyrtare dhe klerit të lartë në lidhje me raportet midis deputetëve të besimit katolik dhe atij mysliman. Kleri i lartë katolik mendonte se një pjesë e anëtarëve të këtij komuniteti, që kishin kontribuar më herët për çështjen kombëtare, nuk përfaqësoheshin si duhet në organet e shtetit shqiptar, duke krijuar një disbalancim në raportet krahinore e fetare. Për ta, përbërja e qeverisë Vroni, mishëronte në vetvete interesat e shtresës konservatore, të trashëguar prej periudhës osmane dhe, nga pikëpamja fetare, mbizotëronte përkatësia myslimane. Në të tillë situatë, ata pretendonin se popullsia katolike duhej të kishte 2/3 e numrit të deputetëve të prefekturës së Shkodrës.³⁵ Ndërkohë, më 12 shkurt 1921, ipeshkvi i Lezhës, imzot Luigj Bumçi i dërgoi një letër ministrit të Punëve të Brendshme, Mehdi Frashëri, nëpërmjet së cilës kërkohej ndryshimi i hartës elektorale, duke e lënë Malësinë e Gjakovës jashtë përfshirjes në prefekturën e Shkodrës. Ky veprim synonte të shmangte rritjen me 44.000 frymë të votuesve myslimanë në qarkun e Shkodrës, pjesë e të cilëve ishin edhe emigrantë kosovarë. E njëjta kërkesë iu bë qeverisë edhe në memorandumun e nënshkruar nga përfaqësues të popullsisë katolike, si edhe Ndoc Pistuli në emër të Komitetit për Zgjedhjen e Deputetëve. Në vijim zgjedhjet u bojkotuan.³⁶

Situata e tensionuar detyroi Tiranën zyrtare të tërhiqej. Më 31 mars 1921, Ministria e Brendshme njoftoi, se qeveria, duke u mbështetur në statistikën austro-hungareze të hartuar gjatë Luftës së Parë Botërore dhe duke marrë parasysh shtesën e popullsisë prej 5% në tri vitet e fundit, pranoi që Shkodra të përfaqësohej me 8 deputetë katolikë dhe 4 myslimanë.³⁷ Mbi këtë bazë, më 24 maj 1921 u arrit marrëveshja midis qeverisë dhe katolikëve të Shkodrës për të dalë në zgjedhje. Gjithashtu,

³⁴ *Arkivi i Ministrisë së Punëve të Jashtme (më tej: AMPJ), Viti (më tej: V.) 1923, Dosja (më tej: D.) 211, fleta (më tej: fl.) 26-27. Raport i Komisionit Hetimor të Lidhjes së Kombeve mbi aktivitetin në Shqipëri gjatë periudhës 19 dhjetor 1922-1 shkurt 1923; B. Meta, *Minoritetet dhe ndërtimi kombëtar në Shqipëri ...*, f. 365-366.*

³⁵ S. Kadria, *Nacionalizmi shqiptar...*, f. 410.

³⁶ *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX...*, vëll. II, f. 113.

³⁷ “Çashtja e zgjedhjeve të deputetvet mori fund”, *Besa shqiptare*, nr. 8, Shkodër, 31 mars 1921, f. 3.

krahina e Bujanit do të shkëputej nga prefektura e Shkodrës dhe midis dy komuniteteve vendosej një barazi sa i përket emërimeve në institucionet lokale.³⁸

Për të siguruar një përfaqësim sa më të denjë në Parlamentin Shqiptar (Këshillin Kombëtar), e pse jo, edhe në qeverinë e dalë pas zgjedhjeve, në listën e kandidatëve shkodranë, u përfshinë personalitete të shquara. Me këtë synohej sipas tyre, jo vetëm përparimi i kombit, por, edhe siguri i të drejtave të kishës e të popullsisë katolike, pasi deputetët “do të kishin një përgjegjësi të rëndë para Zotit, para kombit dhe para historisë”.³⁹ Pas përfundimit të zgjedhjeve në qershor 1921, të drejtën e përfaqësimit e siguruan intelektualë të zëshëm të kohës, ku spikatnin Luigj Gurakuqi, Ndre Mjeda, Hilë Mosi e Gjergj Fishta. Pas strukturimit të Këshillit Kombëtar, ky i fundit u zgjodh edhe nënkryetar i tij. Në tërësi, nga 78 deputetë që ai kishte në përbërje, 28 ishin të krishterë (35,9 %), prej të cilëve 20 deputetë ishin të besimit ortodoks (26%) dhe 8 të atij katolik (10%). Myslimanët përbënin shumicën me 50 deputetë (64%).⁴⁰ Në raport me numrin e përgjithshëm të popullsisë, evidentohet një favorizim i të krishterëve, ku spikasin ortodoksët.⁴¹ Të njëjtën gjë mund të themi edhe për qeverinë e koalicionit të Iljaz Vrionit, e cila kishte në përbërje të saj, 4 ministra të besimit mysliman dhe 4 të atij të krishterë, 3 prej të cilëve të besimit ortodoks.⁴²

Në vijim, niveli i përfaqësimit në Parlamentin Shqiptar u plotësua me atë të diasporës. Zëri i saj u përcoll përmes Federatës Panshqiptare “Vatra” në Shtetet e Bashkuara të Amerikës. Organizata ishte krijuar në

³⁸ B. Çiraku, “Zgjedhjet e para parlamentare në Shqipëri...”, f. 172; S. Kadria, *Nacionalizmi shqiptar...*, f. 413.

³⁹ *Historia e shqiptarëve gjatë shekullit XX...*, vëll. II, f. 113.

⁴⁰ Për listën e plotë të deputetëve të Këshillit Kombëtar, dalë nga zgjedhjet e prillit 1921, shih: K. Dervishi, *Historia e shtetit shqiptar...*, f. 128.

⁴¹ Sipas Teki Selenicës në vitin 1923 popullsia e Shqipërisë ishte 803.959 banorë, nga të cilët myslimanë ishin 529.694 frymë (66%), ortodoksë ishin 168.215 frymë (21%) dhe katolikë 96.050 banorë (12%). Shih: Teki Selenica, *Shqipria më 1923*, Tiranë: Shtypshkronja “Tirana”, 1923, f. 7. Pasqyra e prefekturave mbi sipërfaqen, popullsinë dhe ndarjen administrative të Shqipnis.

⁴² Në përbërje të qeverisë krahas Iljaz Vrionit që mbante postin e Kryeministrit bënin pjesë edhe Sulejman Delvina, Mehdi Frashëri dhe Selahudin Shkoza, të gjithë të besimit mysliman, ndërsa Pandeli Evangjeli, Dhimitër Kacimbra, Sotir Peci e Tef Curani ishin të krishterë, nga të cilët i fundi i besimit katolik. Shih: *Fjalor Enciklopedik Shqiptar*, vëll. III: N-ZH dhe një shtojcë, botim i Akademisë së Shkencave të Shqipërisë, Tiranë: Kristalina-KH, 2009, f. 2157.

prill të vitit 1912 dhe kishte një ndikim të madh në politikën shqiptare, veçanërisht në periudhën e Luftës së Parë Botërore dhe më pas, kur shumë figura të njohura të saj u kthyen në Shqipëri për të ndihmuar rikthimin e pavarësisë dhe ndërtimin e shtetit të ri shqiptar.⁴³ Ministrisë së Punëve të Brendshme dhe asaj të Punëve të Jashtme iu përcoll urdhri i datës 12 janar 1921 i Kryeministrit Iljaz Vrioni, sipas të cilit

“Mbas vendimit të Këshillës Ministrore Nr. 1169 me 28. XII. 1920 e pëlqimit të Këshillës së Naltë Nr. 332/1, më 2. 1. 1921 i jepet e drejta shoqëris Federata Vatra e Amerikës e formume prej një shumice të madhe shqiptarësh e njohtun si një person moral për me pasë një deputet në Parlamentin kombëtar të Shtetit t’onë, me kondicion se ai qi do të zgjedhet si deputet të ndodhet tani n’Amerikë, të ketë ma të paktën tri vjet qi gjendet atje me qëllim qi të jetë i dalun me të vërtetë prej gjinit t’asaj shoqënie”.⁴⁴

Në përgjigje të kërkesës së qeverisë shqiptare, Faik Konica në cilësinë e kryetarit të “Vatres” njoftoi se

“... si depytet i asaj shoqërije për Parlamentin kombëtar asht zgjedhë Imzot Fan Noli, i cili massi asht ndodhun n’Amerikë shumë kohë e ma në fund si përfaqësuesi i Shtetit Shqiptar pranë Lidhjes së kombevet në Genevë ...”.⁴⁵

Më 1 shkurt 1921, Këshilli i Ministrave miratoi vendimin mbi pranimin e imzot Fan Nolit, si deputet në Këshillin Kombëtar.⁴⁶ Ai së bashku me 4 delegatët e Bukureshtit në Kuvendin Kombëtar të Vlorës, qenë zërat e vetëm përfaqësues të kësaj kategorie. Duke nisur nga viti 1923, Parlamenti Shqiptar nuk do të ketë më në gjirin e tij përfaqësues të

⁴³ Për më shumë në lidhje me veprimtarinë e Federatës “Vatra” dhe kontributin e saj në shtetndërtimin shqiptar shih: Beqir Meta, *Federata Panshqiptare “Vatra” (1912-1920)*, botohet me rastin e 90-vjetorit të krijimit të Federatës “Vatra”, Tiranë: Globus R, 2001, f. 115-285.

⁴⁴ *Arkivi Qendror Shtetëror i Republikës së Shqipërisë* (më tej: *AQSh*), Fondi (më tej: F.) 152, Viti (më tej: V.) 1921, Dosja (më tej: D.) 25, fl. 2. Ministrisë së Punëve të Brendshme i përcillet urdhri i datës 12 janar 1921 i Kryeministrit Iljaz Vrioni, Tiranë, 12 janar 1921, fl. 3. Ministrisë së Punëve të Jashtme i përcillet urdhri i datës 12 janar 1921 Kryeministrit Iljaz Vrioni, me shënimin për të lajmëruar sa më parë Federatën Shqiptare “Vatra” në Amerikë, Tiranë, 17 janar 1921.

⁴⁵ *Po aty*, fl. 4. Vendim i Këshillës Ministrore, mbi pranimin e Fan Nolit si deputet në Parlamentin Shqiptar, Tiranë, 1 shkurt 1921; A. Mema, “Zgjedhjet politike të vitit 1921...”, f. 137-138.

⁴⁶ *Po aty*.

diasporës, pavarësisht kontributit të jashtëzakonshëm që kjo e fundit do të japë për shtetin amë.

Aspekti i fundit që mori vëmendje ishte përfaqësimi i shqiptarëve që jetonin jashtë Shqipërisë Londineze, në Jugosllavi e Greqi. Përfaqësimi i kësaj kategorie, pavarësisht dëshirës së vetë shqiptarëve, mbartte vështirësi, të cilat lidheshin me statusin e shtetit shqiptar dhe qëndrimin e Fuqive të Mëdha. Në periudhën në të cilën u zhvilluan zgjedhjet, çështja shqiptare nuk kishte marrë ende zgjidhje përfundimtare. Konferenca e Paqes e mbledhur në Paris në përfundim të Luftës së Parë Botërore, i kishte mbyllur punimet duke ia adresuar çështjet e lëna pezull një tjetër konference, asaj të Ambasadorëve, e cila do të mbledhej në kryeqytetin francez. Kufijtë e shtetit shqiptar vijonin të ishin pjesë e diskutimit mes të Mëdhenjve, të cilët nuk kishin ndërmend të tejkalonin hartën e vitit 1913. Qeveria shqiptare, ndonëse shtrinte autoritetin e saj thuajse në të gjithë territorin, nuk ishte njohur ende nga Fuqitë e Mëdha. Në të tillë situatë politikanët shqiptarë u treguan të kujdesshëm duke e shtrirë nivelin e përfaqësimit kryesisht brenda kufijve të Shqipërisë Londineze.

Në një situatë të tillë, Ligji i Zgjedhjeve i dhjetorit 1920 nuk e përfshiu në nenet e tij përfaqësimin e shqiptarëve jashtë shtetit amë, por i la një shteg të hapur në nenin 22:

“Në vendet e Shqypnis së Sipërme qi nuk mund të dihet numri i banorvet, Qeverija, tue bamë hetimet e duhuna, duhet t’a kuptojë numrin e vendasvet dhe me këtë rasë do të caktojë numrin e Deputetvet”⁴⁷.

Bëhet fjalë për prefekturën e Drinit, e cila në vitin 1921 vijonte të ishte pjesërisht e pushtuar nga ushtria jugosllave.⁴⁸ Numri i deputetëve të kësaj prefekturë dhe modalitetet e zgjedhjes së tyre u përcaktuan në vendimin e qeverisë shqiptare për shtimin e shtatë neneve në ligjin për Zgjedhjen e Deputetëve, më 6 janar 1921, miratuar dy ditë më pas nga anëtarët e Këshillit

⁴⁷ *Akte të Parlamentit Shqiptar 1920-1924...*, f. 190-195. Ligjë për zgjedhje të deputetëve.

⁴⁸ Gjatë procesit të zgjedhjeve lindi problemi i përcaktimit të numrit të zgjedhësve të dytë që duhej të dilnin nga zonat që gjendeshin nën okupimin e ushtrisë jugosllave në anën e djathtë të lumit Drin, si dhe banorëve e “muhaxhirëve” që gjendeshin në anën e majtë të lumit Drin, nën autoritetin e qeverisë shqiptare. Shumica e popullsisë së prefekturës së Drinit u detyrua të shpërngulej në vise të tjera për shkak të represionit të ushtrisë jugosllave dhe vetëm një pjesë e vogël e territorit në jug të lumit Drin, malësia e Dibrës dhe disa fshatra të Lumës ishin nën autoritetin e qeverisë shqiptare. Shih: S. Kadria, *Nacionalizmi shqiptar...*, f. 398-399.

të Naltë.⁴⁹ Sipas nenit 1, prefektura e Drinit do të përmblihdhte zonat e Dibrës së Poshtme, Grykat, Fushat, Gollobordën, Lumën, Lurën e Hasin dhe do të kishte 10 deputetë. Interesante ishte mënyra e zgjedhjes së tyre. Votonin për zgjedhës të dytë emigrantët kosovarë, të shpërngulur nga zona që mbahej e okupuar nga ushtria jugosllave, në të djathtë të lumit Drin. Në nenin 2 bëhej me dije se

“populli i këtyne krahinave që ndodhen në Tiranë, Shijak, Durrës, Elbasan, Krue, Kavajë, e me 300-400 frymë të përgjithëshme ka m’u zgjedhun një zgjedhësi i dytë”. *Neni 3 plotësonte përfaqësimin e vendeve* “qi kanë ngelë për këtëj lumit Drin e qi ndodhen jasht pushtimit të serbëvet kanë me u çuemun dy nëpunës, të cilët në një mbledhje qi kanë për të bamë nën kqyrim të nëpunësit ma të math [lartë] civil, do të zgjedhin zgjedhësit e II me anën e pleqvet, krenëvet e të parive të katundevet”.

Zgjedhësit e dytë do të mblihdeshin në Tiranë “në një ditë të caktueme për të dhanë votat e deputetëvet të tyne. Dy nëpunësit qi kanë me shkue n’ato vende qi ndodhen për këtëj Drinit dhe qi populli i tyne nuk ndodhet i mërguem, masi të gjejnë [marrë] funt të zgjedhunit e zgjedhësve të dytë, kanë me vendue për qendër një vent ose disa vende qi ndodhen mezatar [në mes] dhe kësodore kanë me i mbledhun votat e deputetis. Votimi ka për t’u bamë simbas ligjës së zgjedhjevet”.⁵⁰

Neni i fundit i shtesës ligjore përcaktonte modalitetet në lidhje me atë çka do të ndodhte pasi prefektura e Drinit të lirohej nga Serbia. Kur kjo të ndodhte, deputetët e asaj prefekturë ishin të detyruar

“me i a njohtue vedin popullit qi nuk patë marrë pjesë në zgjedhje dhe në qoft se vërtetohet të zgjedhunit e tyne, quhet i mbaruem, përkundrazi kanë m’u bamë zgjedhje të reja”.⁵¹

Fillimisht Kosova u përfaqësua në Parlamentin Shqiptar me Rexhep Mitrovicën e Mustafa Krujën, të cilët e morën mandatin e përfaqësimit më 5 maj 1921 pas verifikimit nga komisioni parlamentar të ligjshmërisë së zgjedhjes së tyre.⁵² Më 12 shtator 1922 u betuan edhe Qamil Bala,

⁴⁹ *Akte të Parlamentit Shqiptar 1920-1924...*, f. 197-198. Njoftim i Kryeministrit, Iljaz Vrioni, drejtuar Këshillit të Lartë, mbi vendimin e qeverisë për shtimin e shtatë neneve në ligjin “për Zgjedhjen e Deputetëve” dhe miratimin e këtij vendimi nga Këshilli i Lartë, Tiranë, më 6 janar 1921.

⁵⁰ *Po aty*.

⁵¹ *Po aty*, f. 198.

⁵² *Po aty*, f. 208-209. Raport i komisionit parlamentar “B”, i formuar për shqyrtimin e

Bedri Pejani, Halim Gostivari dhe Ibrahim Jakova. Dy muaj më vonë, më 18 nëntor parlamentit iu bashkangjiti edhe Qazim Dani.⁵³

Në një analizë të përgjithshme, në fillim të viteve '20 grupimet e mëdha politike në Shqipëri përfshinë politikanë përfaqësues të Kosovës, të cilët u bënë pjesë aktive e jetës politike në shtetin amë, madje edhe protagonistë aktivë në luftën e brendshme politike. Ata ishin jo vetëm deputetë, por edhe ministra e kryeministra, ku dallohen Hoxha Kadri Prishtina e Hasan Prishtina. Që prej vitit 1925, kjo nuk ndodhi më.

Përfaqësimi i Kosovës në Parlamentin Shqiptar (Këshilli Kombëtar), bëri që të ndjehej e mënjanuar dhe e papërfaqësuar popullsia çame. Më 21 maj 1921, Asaf Çami, kryetar i shoqërisë “Vllazëria Çame, qendra e Atdheut” i dërgoi një kërkesë Këshillit Kombëtar. Në të evidentohet fakti se

“Ligja e zgjedhjeve të deputetëve, ashtu dhe shtimet [shitesat] ligjore për këtë çështje, ju dhan të drejtë përfaqësimi gjith Malësisvet të veriut, e sidomos pjesës së Drinit e Malësisvet të Lumës, Hasit e Bunjës, në të cilat u dëshirua ma tepër një përfaqësim politik se një përfaqësim i vërtetë”⁵⁴. Në kërkesë nuk mungonin tonet patetike dhe gëzimi i shprehur “për këtë mënyrë përfaqësimi për vendet e shkeluna të [brenda] kufivet [të vitit] 1913, e sidomos për ato Malësië që kan të lidhun [lidhje] etnike e istorike me Kosovën e robnueme e me viset e tjera të lindjes”.

Nisur nga sa më sipër, Asaf Çami i paraqeste Parlamentit Shqiptar “dëshirën e ngulun të tij që të vendoset edhe një deputet çam, vetëm çam, të përfaqësojë këtë popull të mjerë e të urtë të çamëve vendas të malësisë së Çamërisë përbrenda kufinit të 1913, të katundit të madh Jannjer, që e mban Greqia jasht vendimit të Konferencës së Londrës, të Florencës, e të emigrantëve të shumtë të përhapur në Shqipëri, punë e cila u ba dhe për vëllezërit tonë dibranë e kosovarë”. Ngjashmërisht me nenin 7 të Ligjit të posaçëm për malësitë e Lumës dhe të Dibrës, ai

zgjedhjeve të anëtarëve të komisionit parlamentar “A”, me kryetar Ibrahim Xhindin, mbi ligjshmërinë e zgjedhjes së deputetëve të Gjirokastrës, Vlorës, Korçës, “Vatrës”, Beratit, Elbasanit, Matit dhe deputetëve të Drinit, Tiranë, më 5 maj 1921.

⁵³ *Ligjvënësit shqiptarë...*, f. 66; K. Dervishi, *Historia e shtetit shqiptar...*, f. 128.

⁵⁴ *Akte të Parlamentit Shqiptar 1920-1924...*, f. 217-218. Kërkesë e përfaqësuesit të popullsisë çame dhe të kryetarit të shoqërisë “Vllazëria Çame, qendra e Atdheut”, Asaf Çami, drejtuar Kryetarit të Parlamentit, mbi hartimin e një ligji të posaçëm për zgjedhjen e një deputeti çam në Parlamentin Shqiptar, Tiranë, më 21 maj 1921.

*kërkonte që të garantohej e drejta për një “nji zgjedhës të dytë në 300 zgjedhës të parë” midis popullsisë çame, e cila “s’ju ka ba barrë ndonji herë shtetit shqiptar, e ka derdhur gjakun e tij për këtë shtet”. Kërkesa mbyllej me lutjen që të përgatitej një “ligjë e posaçme për nji deputet çam për të mirën e këtij elementi e për mosdëshpërimin e tij. Çamëria, e dënueme të rronjë nën thundrën e huaj, të gëzohet së paku që të ket nji bir të saj, në emër të pjesës së lirë, në gji të parlamentit shqiptar e pranë përfaqësuesve të kombit tonë të lirë”.*⁵⁵

Nga kërkimi i derisotëm nuk kemi gjetur të dhëna që Parlamenti Shqiptar ta ketë marrë në diskutim kërkesën në fjalë. Një kërkesë e ngjashme kishte ndodhur edhe një vit më parë, kur Spiro Koleka, përfaqësues i Vlorës, gjatë seancës së parë të Këshillit Kombëtar, më 27 mars 1920 kishte *“çfaqë idhënimin e tij nga se, sheh qi, dy pjesë të Shqipniës Kosova e Çamrija s’përfaqësohen në Këshillën Kombtare e lyp qi, ky idhnim të çfaqet prejë gjith Këshillës...”*⁵⁶. Ndonëse propozimi i tij ishte pranuar me *“zëra të përbashkët”*, duke synuar shmangien e tensionimit me Greqinë, është fakt tashmë që krahina e Çamërisë, pjesa më e madhe e së cilës, me vendim të Konferencës së Ambasadorëve në Londër (1913) i kaloi shtetit grek, nuk u përfaqësua as në Këshillin Kombëtar të vitit 1921, as në parlamentet në vijim.

Përfundime

Tiparet e nivelit të përfaqësimit të vendosura në Kuvendin Kombëtar të Vlorës i dhanë formë modelit me të cilin do të duhej të veprohej edhe në zgjedhjet parlamentare të pranverës së vitit 1921. Dy kapilarët bazikë të tij: përfaqësim sa më të plotë kombëtar, pa përjashtuar diasporën, si dhe respektim në nivelin e përfaqësimit të raporteve të besimeve fetare të popullsisë, u zbatuan pjesërisht në rastin e zgjedhjeve të para parlamentare të prillit të vitit 1921. Pavarësisht shtesave ligjore që pësoi Ligji i Zgjedhjeve i dhjetorit të vitit 1920, përfaqësimi i plotë kombëtar, duke përfshirë edhe shqiptarët në Jugosllavi e Greqi, u arrit pjesërisht. Kosova e gjeti veten të përfaqësuar me deputetë të dalë nga zgjedhjet e zhvilluara në prefekturën e Drinit, ndërsa krahina e Çamërisë mbeti e

⁵⁵ *Po aty*, f. 218.

⁵⁶ *Bisedime Parlamentare 1920-1921*, përgatitur nga Shërbimi i Botimeve parlamentare të Kuvendit të Shqipërisë, Tiranë: 2015, f. 11. Çilja e parë e “Këshillit Kombtar”, më 27 mars 1920.

papërfaqësuar. Për shkak të rrethanave ndërkombëtare, qëndrimin të Fuqive të Mëdha, brishtësisë së shtetit shqiptar dhe marrëdhënieve të tensionuara me fqinjët tokësorë, me të drejtë elita politike në Shqipëri e pa të udhës përqendrimin e nivelit të përfaqësimit kryesisht në territoret e shtetit shqiptar të njohur nga Konferenca e Ambasadorëve në Londër (1913). Ndryshe ndodhi me përfaqësimin e diasporës, zëri i së cilës u përcoll në Këshillin Kombëtar, nëpërmjet Fan Nolit, të zgjedhurit të Federatës Shqiptare “Vatra”.

Tipari i dytë i nivelit të përfaqësimit, që kishte të bënte me respektimin e raporteve të besimeve fetare të popullsisë, pra barazinë e feve, u sanksionua në shtesën ligjore që iu bë Ligjit të Zgjedhjeve, më 18 dhjetor 1921. Por, zbatimi në terren solli favorizim të elementit të krishterë, veçanërisht atij ortodoks, si një arsye kjo për të shmangur propagandat e huaja dhe etiketimin e shtetit shqiptar si shtet mysliman.

Duke nisur nga gjysma e dytë e viteve ‘20, tiparet e nivelit të përfaqësimit të shqiptarëve do të pësojnë sërish ndryshime. Përfaqësimi kombëtar do të rrudhet vetëm në territoret e shtetit shqiptar të konfiguruar e njohur tashmë nga Fuqitë e Mëdha, duke mos u përfaqësuar as diaspora shqiptare, pavarësisht kontributit të pashoq që ajo kishte dhënë dhe vijonte të jepte në shtetndërtimin shqiptar. Ndërkohë respektimi në nivelin e përfaqësimit i raporteve fetare të popullsisë do të zbatohet më rigorozisht, një shenjë kjo e forcimit të shtetit, stabilitetit ndërkombëtar dhe vendosjes së ekuilibrave mes besimeve fetare në Shqipëri.

S u m m a r y

FROM WARTIME MANDATED DELEGATES INTO PEACETIME ELECTED MP’S:
A COMPARATIVE OVERVIEW OF THE REPRESENTATION FEATURES IN THE VLORA
NATIONAL ASSEMBLY AND IN THE PARLIAMENT OF 1921

Article “From wartime mandated delegates into peacetime elected MP’s: A comparative overview of the representation features in the Vlora National Assembly and in the Parliament of 1921” aims to explain and compare as well the features of representation of the Albanians in two key moments, initially in the National Assembly of Vlora (1912) and then the 1921 elections. It is not by chance that the National Assembly of Vlora was considered as an initial point, because there in Vlora was established the model with two main capillaries

upon which the representation of the Albanians should be continued in the future as well. The Parliamentary Elections of 1921 are the first in the history of the Albanian, held throughout peacetime, from which emerged a classic type of parliament. The article itself has a parallel-comparative approach, as well as historical and juridical one, between these two key moments throughout the history of the formation of the Albanian state, which makes its novelty too. It reaches the conclusion that the two basic capillaries delineated by the National Assembly, fully national representation, without excluding diaspora, as well as respecting by level of representation the religious ratio of population, were partially implemented during the first parliamentary elections of April 1921.

Despite, legal additions of the Law of Elections of December 1920, the whole national representation, including the Albanians in Yugoslavia and Greece, was partially accomplished. In a camouflaged way, Kosovo was represented by MPs from the elections held in the prefecture of Drini, while the province of Çamëria remained unrepresented. Due to international circumstances, the attitude of the Great Powers, fragility of the Albanian state and tense relations with territorial neighbours, the Albanian elite considered right the focus of the level of representation mainly in the territories of the Albanian state, recognized by the Conference of Ambassadors in London (1913). It differently happened with the representation of the diaspora, whose voice was conveyed to the National Council, through Fan Noli, elected by the Albanian Federation "Vatra". The second feature of the level of representation, which was concerned with the respect of the ratios of the religious beliefs of the population, so the equality of religions, was sanctioned in the legal addition made to the Election Law, on December 18, 1921. However, its implementation in the territory favoured the Christian element, especially the Orthodox one, as a reason to avoid foreign propaganda and naming the Albanian state as a Muslim country.

